



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 245, Datë 09.08.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SELCA”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pika 1 dhe 3 dhe 15, pika 4 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika, 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.08.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1974/1 prot., datë 04.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 05.05.2010, i ndryshuar, është licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.07.2023, ka paraqitur aplikimin për modifikimin e kësaj licence për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC Selcës nga 1.6 MW në 1.98 MW.
- Në pikën 2.3 të Licencës për Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike, parashikohet se: *Çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar në Aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj Licence.* Rezulton se rritja e kapacitetit të instaluar nga 1.6 MW në 1.98 MW, kalon kufirin e identifikuar në Aneksin A.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi sipas përcaktimeve të Aneksit A, të Rregullores dhe po ashtu rezulton se ka shlyer të gjitha detyrimet e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 15, pika 4, gërmat “a”, “b” dhe “c”.

Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

**Neni 15 “Modifikimi i Licencës”,**

**Pika 4**

- **gërma “d”:** ERE do të kërkojë qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapaciteti të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara.
- **gërma “e”:** Duhet të depozitohet qëndrimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi rritjen e kapacitetit të instaluar.
- **gërma “f”:** Duhet të depozitohet qëndrimi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në rast se leja për përdorimin e burimit ujor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” me kapacitet të shtuar prej 380 kW.
- **gërma “g”:** Shkresa e OSSH sh.a. në lidhje me miratimin e shtesës së kapacitetit duhet të depozitohet origjinal ose fotokopje e njësuar me origjinalin.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike dhënë shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 05.05.2010, i ndryshuar, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selcës” nga 1.6 MW në 1.98 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**